

Shërbim asistence i Vazhdueshëm (ish Guardia medica)

- Asistencë e vazhdueshme Telefonike
- Ambulatorë për asistencë të vazhdueshme

Ky shërbim garanton një vazhdimësi të aktivitetit të Mjekut të Familjes dhe Pediatri, që keni zgjedhur, në ato ditë e në ato orare kur këta nuk janë prezent: gjatë orëve të natës, në ditët para festave dhe gjatë festave. Shërbimet që ofron përputhen me ato të Mjekut të familjes dhe të Pediatri.

Shërbimi i asistencës së vazhdueshme është aktiv nga ora 20 deri në orën 8 në ditë pune dhe nga ora 8 të së shtunës, o të ditëve para festave, deri në orën 8 të së hënës ose ditës së punës tjetër.

Telefonatës, e cila rregjistrohet për të mbrojtur si qytetarin ashtu edhe shërbimin, i përgjigjet mjeku i rojes kompetent për territorin. Mjeku pasi ka marrë të dhënat personale inkuadron problemin shëndetsor dhe mund të:

1. japi këshillim telefonik;
2. japi udhëzime për vizitë ambulatori në rast nevoje
3. vendos të kryejë vizitë shtëpie

Mjeku i rojes mund të japi recetë, me shënimin “Servizio Continuita assistenziale” ku këshillohet shtrim në spital, çertifikatë sëmundjeje (rraport) për puntorët maksimumi tre ditëshe, ilaçe për terapi në raste urgjence për të mbuluar një periudhë jo më të gjatë se 48-72 orë; në raste shëndetsore të rënda mjeku telefonon direkt 118 për të thirrur ambulancën në vend.

Nëse keni nevojë për mjekun e rojes telefonojini numrit kompetent për territorin tuaj.

Oraret

nga e hëna deri të premten: 20.00-8.00

të shtunën dhe para festave: nga ora 8.00 deri në orën

8.00 të ditës tjetër mbas fundjavës apo festave.

Zona Forlì

Tel. 800 533118

Zona Cesena

Tel. 800 050909

Zona Ravenna

Tel. 800 244244

Zona Rimini

Tel. 0541 787461

Qendra Urgjente e Asistencës (Centro di Assistenza Urgenza CAU) është një strukturë shëndetsore ku në mënyrë të vazhdueshme punojnë mjekë dhe infermierë, të formuar, të gatshëm për të asistuar pacientët me probleme urgjente jo të rënda. Qendra është e hapur të shtata ditët e javës dhe pranimit bëhet direkt.

Tek CAU shërbimet e mëposhtme janë FALAS :

- Vizitë mjeksore
- Çertifikata
- Trajtim farmakologjik kur nevojitet
- Rekomandim mjekimi/medikamentesh në rast sëmundjesh të reja apo në raste terapie mjeksore esenciale
- Ndërhyrje kirurgjikale të vogla (p.sh., qepje apo mjekim plagësh)
- Ndihmë specifike në prani të ngjarjeve me origjinë traumatike

Qytetari që i drejtohet CAU pritët nga një infermier i cili e interviston për të marrë të dhëna mbi nevojën e tij mjeksore dhe më pas vizitohet nga mjeku për të arritur në një diagnozë. Mjeku më pas vlerëson nëse është e nevojshme të rekomandoj vizita tek specialisti apo jo. Rezultati i vizitës së kryer tek CAU gjendet në Fashikullin Elektronik Shëndetsor të qytetarit.

Pasi të jenë kryer të gjitha thëllimet e sygjeruara, fashikulli duhet të vlerësohet nga mjeku bazës/familjes apo pediatri që është zgjedhur, pasi janë pika e referimit për qytetarin i cili nuk duhet të rikthehet tek CAU.

(3)



Ndërmjetësim kulturor, informazione të dobishme për qytetarët e huaj.

Ndërmjetësimi kulturor ka si qëllim, nëpërmjet mediatorëve kulturor të kombësive të ndryshme dhe përkthyesve, të ndihmoj qytetarët e huaj në përdorimin e strukturave dhe të shërbimeve shëndetsore duke ofruar mbështetje në procesin e diagnozave dhe të mjekimeve.

Në zona të ndryshme të territorit gjenden sportele aktive të ndërmjetësimit kulturor dhe gjatë gjithë harkut ditor është i gatshëm një shërbim kulturor, me thërritje, si për personat e shtruar (i aktivizuar nga struktura e shtrimit) si për pacientët e ambulatorëve (nën kërkesën e operatorëve)

Në shërbimin kulturor përfshihen, përveç përkthimit të dokumentave klinik edhe përkthime e përhapje të materialeve informuese, në rastet kur nevojitet, dedikuar të huajve.

Në strukturat shëndetsore të vendosura në bregdetin e Romagna-s është i disponueshëm një shërbim përkthimi.

Qytetari i huaj mund të drejtohet njëherë prej strukturave fikse të Ndërmjetësimit kulturor për të pasur informacionet e duhura në lidhje me procesin mjeksor.

Në rast shtrimi në Spital, Ndërmjetësimi kulturor mund të aktivizohet direkt nga operatorët shëndetsorë, informacione të dobishme në italisht, arabisht, frëngjisht, kineze dhe anglisht

Urgjenca (pronto soccorso) dhe Ndhma e shpejtë

Urgjenca shërben për personat me nevoja mjeksore urgjente.

Për situata jo urgjente drejtoheni direkt mjekut të familjes ose rojes mjeksore (guardia medica).

Nëse i drejtoheni Urgjencës pa nevojë reale urgjente paguani 25 euro për vizitën e parë të kryer nga mjeku i Urgjencës.

Pikat e Para të Ndërhyrjes (PPI, punti di primo intervento) ndërhyjnë në rast sëmundjeje urgjente jo shumë të rëndë. Në raste urgjence të rënda në këto pika bëhet vetëm stabilizimi dhe transportimi i pacientëve në Urgjenca (pronto soccorso) më të përshtatshme për këto raste. Këtu mund të konsultoni numrin e "hyrjeve të pacientëve në Urgjencë", në bazë të rëndesës së urgjencës e kompleksitetit të vlerësimit të kuadrit klinik dhe kohën pritëse mesatare të 24 orëve të fundit

Përparsia për pranim në Urgjencë

I drejtohen Urgjencës personat që kanë nevojë për ndihmë mjeksore urgjente.

Mund të shkohet në Urgjencë vetë ose me ambulancë, në rastet më të rënda, duke telefonuar numrin 118. Vizita në Urgjencë bazohet mbi përparsinë e rëndesës së urgjencës, ku çdo urgjencë klasifikohet në bazë të një

kodi me ngjyrë:

kodi kuq:

Situatë shumë kritike, ndërhyrje e menjëhershme.

kodi portokalli:

Situatë kritike, ndërhyrje e shpejtë, 15 minuta pritje maksimumi.

kodi bojqielli:

urgjencë që pret, 60 minuta pritje maksimumi

kodi jeshil:

situatë pak kritike, urgjencë e ulët, pritja 120 minuta

kodi bardhë:

situatë jo kritike, pranim jo urgjent, 240 minuta.

Në raste jo urgjente është e arsyeshme ti drejtoheni direkt **mjekut të familjes.**

Ngjyra e kodit caktohet gjatë vlerësimit të kuadrit klinik me të cilin garantohet fakti që pranimi në urgjencë të bëhet sipas kriterit të urgjencës.

Triazhi (vlerësimi i kuadrit klinik) është në kompetencën e infermierëve. Për të caktuar përparsinë e urgjencës konsiderohet problemi kryesor shëndetsor, sa kritik është, rreziku i përkeqësimit dhe mjekimi më i përshtatshëm. Në caktimin e kodit merren parasysh edhe faktorë të tjerë, si niveli i dhimbjes, mosha, sa delikat është pacienti dhe nëse ka endikap, dhe situata në kontekst. Bëhet fjalë për një proces dinamik, ku situata vlerësohet periodikisht sepse gjendja e pacientëve në pritje për tu vizituar nga mjeku mund të përmirsohet ose përkeqsohet dhe si rrjedhojë mund të lindi nevoja për të rishikuar përparsinë dhe procedurën e mjekimit.

Pagesa e urgjencës

Mjekimi në Urgjencë (pronto soccorso) është falas vetëm në rastet kur konsiderohet me të vërtetë një urgjencë. Nëse i drejtoheni urgjencës në raste jo urgjente shërbimi që ju ofrohet është me pagesë dhe kushton 25 euro vizita e parë e kryer nga mjeku i urgjencës.

Kësaj pagese i shtohen:

- 23 euro për çdo tjetër vizitë konsultimi që në raste të caktuara mund të kërkoj mjeku i urgjencës
 - Një pagesë maksimale prej 36.15 euro për çdo 8 ndërhyrje të së njëjtës fushë (p.sh. analiza laborator, vizita radiologjike) të porositura nga mjeku i urgjencës, me përjashtimet e parashikuara nga normativa (pamvarësisht nga vlera totale e kontrolleve të porositura).
- Kush i drejtohet urgjencës për arsyet e mëposhtme nuk paguan:
- trauma brenda 24 orëve të mëparshme
 - trauma që ka ndodhur më parë se 24 orë dhe ka qënë e nevojshme ndërhyrja mjeksore
 - helmim akut
 - aksident në punë

- dhimbje veshkash, krizë azmatike, dhimbje kraharori, aritmi, glaukomë akute, prani e një sendi të huaj në sy, rrjedhje gjaku nga hunda, send i huaj në vesh
- ndërlikim pas një operacioni kirurgjikal që shtyn pacientin të shkoj në urgjencë brenda 3 ditëve pas nxjerrjes nga spitali
- probleme dhe simptoma të lidhura me shtatzaninë

Gjithashtu nuk paguan kush:

- shtrohet në repartin e terapisë intensive (OBI) për shqyrtime mjeksore të mëtejshme për të cilat nevojitet nga 6-24 orë shqyrtim
- shtrohet në cilido repart të spitalit
- i drejtohet urgjencës me kërkesë të mjekut/pediatrit të familjes, mjekut të rojes ose të mjekut të një urgjence tjetër
- është nën 14 vjeç
- përjashtohet nga pagesa për patologji, për arsye ekonomike o në bazë të normativës së parashikuar në nivel kombtar apo rajonal
- është i huaj përkohësisht i pranishëm (STP) me deklaratë varfërie

I huaji përkohësisht i pranishëm nuk ka për detyrim paraqitjen e dokumentave në lidhje me lejen e qëndrimit për tu ndjekur nga ana mjeksore. Pranimi i tij në strukturat mjeksore publike, në emilia-romagna, nuk përbën senjalizim në autoritetet gjyqsore.

